

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin /L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr¹ i prokurimit

652-26-2733-5-2-1

Titulli: **“Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përroskave”**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“Design Project Technology & Euro Commerce ” Sh.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtine

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

049 379 100

(Numri Telefonit)

N/A

Arta Koliqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Numri i Faks-it)

designprojecttechnology@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 24.04.2026

Hapja e ofertave: 18.05.2026

Njoftimi mbi vendimin e AK: 23.07.2026

Kërkesë për qasje në dokumentacion : 23.07.2026 - **(Nuk është ofruar qasje fare)**

Kërkesa për rishqyrtim: 28.07.2026

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim: 30.07.2026

Ankesa në OSHP: 10.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Procesverbalin e hapjes e kemi pranuar përmes sistemit të E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 28.07.2026.

Refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 30.07.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qëllimi: Ky nen përcakton qëllimin e ligjit, i cili është të rregullojë procedurat për prokurimin publik në mënyrë të drejtë, transparente dhe konkurruese.

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti: Autoriteti kontraktues është i obliguar të sigurojë përdorim sa më efikas dhe ekonomik të fondeve publike gjatë procesit të prokurimit.

Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi: Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa diskriminim në asnjë fazë të procedurës së prokurimit.

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve: Përcakton rregullat dhe kriteret për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë.

dëshmimin e aftësive teknike dhe profesionale që duhet të përmbushin operatorët ekonomikë për të qenë të kualifikuar për kontratën përkatëse.

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë: Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin.

Neni 97 Shkeljet e rënda i RREGULLORES Nr. 001/2022 - Shkelje të rënda konsiderohen: Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Rregulloren e Udhëzimit operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me datë 23.07.2026 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK, duke na eliminuar si GOE te pa përgjegjshëm edhe pse oferta jonë plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret e shfaqura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit nga Autoritet Kontraktues. Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 28.07.2026 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ndërsa refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 30.07.2026.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues nuk është i bazuar në fakte dhe nuk e pasqyrojnë gjendjen reale dhe faktike të procedurës së prokurimit.

Në vijim të kësaj kërkesë për rishqyrtim, do të paraqesim në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të argumentuar pretendimet tona ankimore. Këto pretendime do të mbështeten në prova konkrete dhe dokumentacion përkatës, përmes të cilave vërehet qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe me obligimet që burojnë nga dokumentet e tenderit.

Pretendimi 1 - Shkelja e të Drejtës për Qasje në Dokumentacion dhe Parimi i Barazisë në Trajtim

Në përputhje me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, më datë 23.07.2026 kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentacionin përkatës të aktivitetit të prokurimit. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk na ka mundur qasjen në dokumentacionin e kërkuar.

Moslejimi i qasjes në dokumentacionin zyrtar të aktivitetit të prokurimit, përkundër kërkesës së shkruar të Operatorit Ekonomik dhe pas publikimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, nuk paraqet vetëm shkelje procedurale, por një veprim të cilit legjislacioni dytësor i prokurimit publik e klasifikon si shkelje të rëndë.

Në kuptim të nenit 97.1 pika (c) të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, moslejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të palës së interesit, kur kjo qasje është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, përbën shkelje të rëndë.

Për më tepër, sipas nenit 99.2 të kësaj Rregulloreje, shkeljet e rënda të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor mund të sjellin masa disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit nga ana e Bordit të KRPP-së.

Prandaj, veprimi i Autoritetit Kontraktues ka cenuar parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe ushtrimit efektiv të së drejtës për ankesë, duke e bërë këtë shkelje me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjshmërinë e procedurës së prokurimit.

Ky mosofrim i qasjes përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë dhe transparencës në procedurën e prokurimit publik, duke cenuar të drejtat tona si palë e interesuar.

Nenin 7 të **Rregullores Nr. 001/2022**, i cili përcakton qartazi se Autoriteti Kontraktues duhet **të ofrojë qasje të shpejtë dhe efikase në dokumentacionin e tenderit dhe dokumentet relevante të procedurës.**

Kjo sjellje administrative kufizon të drejtën tonë për të ushtruar një mjet efektiv ligjor brenda afatit të paraparë dhe cenon parimin e transparencës dhe drejtësisë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 97

Shkeljet e rënda

RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

a. Mashtrimi, kërcënimi, apo ushtrimi i çfardo presioni ose ndikimi të çfardo lloji që ushtrohet ndaj zyrtarit të prokurimit ose në një personi tjetër të përfshirë në një aktivitet të prokurimit në mënyrë që zyrtari tjetër të kryej vlerësimin në kundërshtim me këtë ligj.

b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit;

c. **Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.**

Konform Ligjit për Prokurim Publik veprimet e ZPP-se konsiderohen shkelje të rënda, ku me këtë rast arrijmë deri te revokimi i çertifikatës profesionale të prokurimit.

Neni 99

Masat disiplinore për shkeljet të rënda

RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar

99.2 Për shkelje të rënda të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe legjislacionit dytësor duke përfshirë edhe ato të specifikuara në paragrafin 97.1 të kësaj rregullore, Bordi i KRPP-së do të nxjerrë **vendim për anulim të çertifikatës së prokurimit dhe do të kërkojë nga autoriteti kontraktues marrjen e masave disiplinore ndaj personit në fjalë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.**

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Pretendimi 2 – Mosdhënia e qasjes krijon dyshime serioze mbi ligjshmërinë e procesit të vlerësimit

Moslejimi i qasjes në dokumentacionin zyrtar ka krijuar dyshime të arsyeshme lidhur me mënyrën e zhvillimit të procesit të vlerësimit.

Për shkak se nuk kemi pasur mundësi të shqyrtojmë ofertat dhe dokumentacionin përkatës, nuk kemi qenë në gjendje të verifikojmë nëse operatorët ekonomikë pjesëmarrës, përfshirë operatorin e rekomanduar për kontratë, kanë plotësuar të gjitha kërkesat administrative, teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Kjo mungesë transparence cenon besueshmërinë e procesit të prokurimit dhe krijon dyshime të bazuara se vlerësimi mund të mos jetë zhvilluar në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi 3 - Eliminimi i padrejtë për kompaninë tonë lidhur me kualifikimet e kërkesave teknike profesionale.

Lidhur me arsyen e eliminimit për mosdorëzimin e dy librezave të qarkullimit

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka përmbushur kërkesën e Dosjes së Tenderit, me arsyetimin se nuk janë dorëzuar dy librezat të qarkullimit për dy kamionët vetëshkarkues të ofruar në bazë të marrëveshjes për shfrytëzimin e pajisjeve.

Ky konstatim është i pabazuar në ligj, joproporcional dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili autorizon dhe obligon Autoritetin Kontraktues që, gjatë fazës së vlerësimit, të kërkojë sqarime ose plotësime të dokumentacionit kur dokumentet apo faktet e kërkuara kanë ekzistuar para afatit për dorëzimin e ofertave dhe autenticiteti i tyre është lehtësisht i verifikueshëm.

Në rastin konkret, mungesa e dy librezave të qarkullimit nuk përbën mungesë të kapacitetit teknik apo profesional dhe as nuk ndryshon përmbajtjen materiale të ofertës. Këto dokumente kanë ekzistuar para afatit për dorëzimin e ofertave, janë dokumente zyrtare të lëshuara nga organet kompetente dhe verifikimi i tyre është objektiv, i thjeshtë dhe nuk krijon asnjë avantazh konkurrues për Operatorin Ekonomik.

Prandaj, në pajtim me nenin 72 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të kërkojë sqarim ose plotësim të këtij dokumentacioni, në vend se të zbatojë një qasje tej mase formaliste dhe të marrë vendim për eliminim. Mosshfrytëzimi i mekanizmit të paraparë me nenin 72 përbën shkelje të procedurës së prokurimit dhe cenon parimet themelore të

proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, konkurrencës efektive dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

Për më tepër, qëllimi i kriterit të kërkuar nga Dosja e Tenderit nuk është verifikimi formal i ekzistencës së një kopjeje të librezës së qarkullimit, por verifikimi i disponueshmërisë ligjore dhe faktike të pajisjeve që do të angazhohen në realizimin e kontratës. Ky qëllim është përmbushur plotësisht nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë, pasi pajisjet janë deklaruar, janë vënë në dispozicion përmes marrëveshjeve përkatëse dhe posedojnë dokumentacionin përkatës të regjistrimit.

Për rrjedhojë, eliminimi i Grupit të Operatorëve Ekonomikë për këtë arsye përbën një interpretim tepër formalist të kërkesave të Dosjes së Tenderit, në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e nenit 72 të LPP-së, si dhe me praktikën e konsoliduar të Organi Shqyrtues i Prokurimit, sipas së cilës mungesat që kanë të bëjnë me dokumente ekzistuese dhe lehtësisht të verifikueshme nuk duhet të rezultojnë automatikisht me eliminimin e ofertuesit, por duhet të trajtohen përmes procedurës së kërimit të sqarimeve.

Praktika e vazhdueshme e OSHP-së ka theksuar se **nuk lejohet eliminimi automatik i operatorit ekonomik pa u shfrytëzuar fillimisht mekanizmi i kërimit të sqarimeve**, kur dokumenti i munguar ka ekzistuar para afatit të ofertimit dhe nuk ndryshon përmbajtjen materiale të ofertës.

Në rastin konkret, librezat e qarkullimit kanë qenë dokumente zyrtare të lëshuara shumë kohë para afatit të ofertimit. Ato nuk janë krijuar pas hapjes së ofertave, nuk ndryshojnë ofertën ekonomike, nuk ndryshojnë kapacitetin teknik dhe nuk krijojnë asnjë përparësi konkurruese. Përkundrazi, ato vetëm dëshmojnë një fakt juridik që ka ekzistuar paraprakisht.

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Pretendimi 4-Operatori Ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar ofertë administrativisht të papërgjegjshme

ARSYETIM

Vetëm pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues na mundësoi qasje në dokumentacionin e ofertave.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, kemi konstatuar se sigurimi i tenderit i dorëzuar nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Njoftimin për Kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

Operatori Ekonomik i rekomanduar, VLERA SHPK, ka ofertuar me periudhë të validitetit të tenderit prej nëntëdhjetë (90) ditësh..

Sipas nenit 28.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), përcaktohet se:

"Sigurimi i tenderit do të qëndrojë valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit."

Rrjedhimisht, duke qenë se periudha e validitetit të tenderit ka qenë 90 ditë, sigurimi i tenderit është dashur të jetë valid për së paku 120 ditë, përkatësisht edhe për tridhjetë (30) ditë pas skadimit të validitetit të tenderit.

Në rastin konkret, sigurimi i tenderit i dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar, nuk e mbulon periudhën e kërkuar të validitetit dhe, për pasojë, kërkesa lidhur me sigurimin e tenderit nuk është përmbushur.

Gjithashtu, neni 57, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, përcakton se:

"Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të paraqitur nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit."

Bazuar në dispozitat e lartcekura, oferta e Operatorit Ekonomik të rekomanduar, VLERA SHPK, është e papërgjegjshme, pasi sigurimi i tenderit nuk e mbulon periudhën e kërkuar të validitetit. Për këtë arsye, oferta e këtij operatori ekonomik nuk i plotëson kushtet për t'u rekomanduar për dhënien e kontratës.

Sigurimi i tenderit përbën dokument administrativ të detyrueshëm, i cili duhet të dorëzohet brenda afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Në pajtim me nenin 57 të Ligjit për Prokurimin Publik, kur Autoriteti Kontraktues ka vendosur kërkesë për sigurimin e tenderit, tenderi i operatorit ekonomik që nuk e përmbush këtë kërkesë refuzohet dhe nuk vlerësohet më tutje.

Meqenëse sigurimi i tenderit nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, kjo mangësi nuk mund të trajtohet si mangësi e riparueshme dhe nuk mund të plotësohet pas afatit për dorëzimin e tenderëve.

Si perfundim, Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk e ka përmbushur kërkesën ligjore dhe kërkesën e Dosjes së Tenderit lidhur me vlefshmërinë e sigurimit të tenderit. Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se ai ka ofertuar me periudhë të vlefshmërisë së tenderit prej 90 ditësh, ndërsa sigurimi i tenderit është lëshuar po ashtu me vlefshmëri prej 90 ditësh.

Kjo bie në kundërshtim me nenin 28.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024, i cili përcakton

shprehimisht se sigurimi i tenderit duhet të mbetet valid edhe për tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Rrjedhimisht, në rastin konkret sigurimi i tenderit është dashur të ishte i vlefshëm së paku 120 ditë.

Për më tepër, neni 57 paragrafi 2 i Ligjit për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues që të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik i cili nuk e ka përmbushur kushtin e sigurimit të tenderit. Duke rekomanduar për kontratë një operator ekonomik që nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 57 të LPP-së dhe nenin 28.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, duke e bërë vendimin e tij të kundërligjshëm.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar ta refuzojë ofertën dhe të mos vazhdojë me vlerësimin e saj të mëtejme.

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Pretendimi 5 –Operatorët Ekonomikë tjerë ofertues janë të papërgjegjshëm për shkak të skadimit të validitetit të ofertave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tenderit rezulton se operatorët ekonomikë ofertues kanë ofertuar me periudhë të vlefshmërisë së ofertës prej 60 ditësh, duke filluar nga data e hapjes së tenderëve, 18.05.2026. Rrjedhimisht, periudha e vlefshmërisë së ofertave ka skaduar më 17.07.2026.

Interpretimi zyrtar i KRPP-së, i datës **22.11.2022**, ka sqaruar në mënyrë të qartë se **asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet mbi bazën e një oferte me validitet të skaduar**. KRPP ka theksuar se:

"Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj, KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës."

Po të ishte mundësuar qasja në dokumentacion në kohën e duhur, këto shkelje do të ishin evidentuar dhe ngritur që në fazën administrative të procedurës. Për rrjedhojë, veprimi i Autoritetit Kontraktues jo vetëm që ka kufizuar të drejtën tonë për një mjet juridik efektiv, por ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mundësinë tonë për të ushtruar në mënyrë të plotë të drejtat procedurale të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Përfundimisht bën vetëm Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë, i cili ka ofertuar me periudhë të vlefshmërisë së ofertës prej 90 ditësh dhe ka dorëzuar sigurimin e tenderit me vlefshmëri prej 180 ditësh, duke përmbushur plotësisht kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të Rregullores për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, në momentin kur ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë kishin humbur vlefshmërinë juridike, oferta e Grupit tonë të Operatorëve Ekonomikë vazhonte të jetë e vlefshme dhe për t'u shpallur fituese.

Kërkojmë që të gjitha pretendimet tona të mirren seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikat e OSHP-së.

Autoritet Kontraktues NUK e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si Operator Ekonomik të përgjegjshëm me cmimin më të lirë dhe duke rekomanduar OE te papërgjegjshëm. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoritet Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

I.APROVOHET, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **Design Project Technology & Euro Commerce SH.P.K., Prishtine, Kosovë**

II.OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues- **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**, që të kthejë lëndën në **Ri-vlerësim** dhe me rastin e ri-vlerësimit të ofertave të rekomandohemi për kontratë ne si Grup i Operatoreve Ekonomik të vetmit të përgjegjshëm me cmimin më të lirë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionin përcjellës,
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundëshme,
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*